



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 539 prot.

Himarë, më 23.07 . 2026

Lënda: Dërgohet për miratim projektvendimi “Për vijimin e procedurave për shpronësim për interes publik në kuadër të projektit “Ndërtim & Rikualifikim i Rrugës Paralele me Rrugën e Plazhit, Borsh”.

KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË

✓ **Himarë**

Mbështetur në ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, si dhe VKM-në nr. 408/2015 (i përditësuar me anë të VKM nr.377/2024) “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, ligjin nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” (i përditësuar), relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë me qëllim evidentimin, identifikimin dhe sistemimin e rrjetit të rrugëve ekzistuese që ndodhen brenda territorit administrativ të Bashkisë Himarë:

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

- Projekt vendimin “Për vijimin e procedurave për shpronësim për interes publik në kuadër të projektit “Ndërtim & Rikualifikim i Rrugës Paralele me Rrugën e Plazhit, Borsh”.
- Relacion: Mbi projekt vendimin “Për vijimin e procedurave për shpronësim për interes publik në kuadër të projektit “Ndërtim & Rikualifikim i Rrugës Paralele me Rrugën e Plazhit, Borsh”.

KRYETARI

Vangjel Tavo

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETARI

Erifili Berberi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KRYETARI

Nr. 5391 / prot.

Himarë, më 23.07.2026

PROJEKT VENDIM

Nr. 51, Datë 23.07.2026

PËR

**“VIJIMIN E PROCEDURAVE PËR SHPRONËSIM PËR INTERES PUBLIK NË
KUADËR TË PROJEKTIT
“NDËRTIM & RIKUALIFIKIM I RRUGËS PARALELE ME RRUGËN E PLAZHIT,
BORSH ”**

Mbështetur në ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, si dhe VKM-në nr. 408/2015 (i përditësuar me anë të VKM nr.377/2024) “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, ligjin nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” (i përditësuar), relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë:

VENDOSI:

1. Miratimin e vijimit të procedurave për shpronësim për interes publik në kuadër të projektit “Ndërtim & Rikualifikim i Rrugës Paralele me Rrugën e Plazhit, Borsh ”, sipas hartës dhe gjurmës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Kryetari dhe administrata e Bashkisë Himarë për vazhdimin e procedurave të shpronësimit për interes publik në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, deri në miratimin e aktit normativ të shpronësimit për interes publik.
3. Vlera financiare paraprake e shpronësimit për pronat që preken nga projektit “Ndërtim & Rikualifikim i Rrugës Paralele me Rrugën e Plazhit, Borsh”, do të përballohet nga Buxheti i Bashkisë Himarë.
4. Ngarkohet Bashkia Himarë përmes sektorëve teknikë dhe urbanistikës, për përgatitjen, plotësimin dhe administrimin e të gjithë dokumentacionit teknik dhe ligjor të nevojshëm për vijimin e procedurave të shpronësimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Ngarkohet Bashkia Himarë përmes njësive të komunikimit, për komunikimin dhe informimin e publikut, të kryejë publikimin e këtij vendimi dhe të dokumentacionit përkatës, si dhe të informojë subjektet e interesuara dhe publikun, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata dhe Kryetari i Bashkisë Himarë.
7. Ky Vendim hyn në fuqi bazuar në ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 55 pika 6.

KRYETARI

Vangjel Tavo

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZËVENDËSKRYETARI

Erifili Berberi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 5391/prot.
2

Himarë, më 23.07 . 2026

RELACION

**MBI PROJEKT VENDIMIN “PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE PËR SHPRONËSIM
PËR INTERES PUBLIK NË KUADËR TË PROJEKTIT ‘NDËRTIM & RIKUALIFIKIM
I RRUGËS PARALELE ME RRUGËN E PLAZHIT, BORSH”**

Të nderuar Këshilltarë!

Projekt-Vendimi që po ju paraqesim vjen si rezultat i nevojës së Bashkisë Himarë për vijimin e procedurave të shpronësimit për interes publik në funksion të realizimit të projektit “Ndërtim & Rikualifikim i Rrugës Paralele me Rrugën e Plazhit, Borsh”.

Ky projekt përbën një investim me rëndësi për zhvillimin e infrastrukturës rrugore, përmirësimin e aksesit dhe rritjen e sigurisë së qarkullimit në zonën e Borshit. Për zbatimin e tij është identifikuar nevoja për vijimin e procedurave të shpronësimit të pasurive private që preken nga gjurma e projektit, në përputhje me projektin teknik, dokumentacionin përkatës dhe legjislacionin në fuqi. Vijimi i këtyre procedurave është i domosdoshëm për realizimin e investimit dhe garantimin e interesit publik.

I. Baza Ligjore

Ky relacion mbështetet në kuadrin e legjislacionit në fuqi, përkatësisht:

- Ligjin nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar;
- Ligjin nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar;
- VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, e përditësuar me VKM nr. 377/2024;

II. Qëllimi i projekt-vendimit

Projekt-vendimi synon të miratojë vijimin e procedurave për shpronësim për interes publik në kuadër të realizimit të projektit “Ndërtim & Rikualifikim i Rrugës Paralele me Rrugën e Plazhit, Borsh”.

Ky miratim përfshin:

- vijimin e procedurave të shpronësimit pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësim dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
- administrimin dhe plotësimin e dokumentacionit teknik dhe ligjor të nevojshëm për procedurën e shpronësimit;
- garantimin e mbulimit të vlerës paraprake të shpronësimit nga buxheti i Bashkisë Himarë;
- përmbushjen e detyrimeve ligjore për informimin dhe publikimin e procedurave ndaj subjekteve të interesuara dhe publikut.

III. Përshkrimi i propozimit

Propozimi konsiston në miratimin nga Këshilli Bashkiak të vijimit të procedurave për shpronësim për interes publik për pasuritë që preken nga zbatimi i projektit “Ndërtim & Rikualifikim i Rrugës Paralele me Rrugën e Plazhit, Borsh”, sipas projektit teknik dhe hartës bashkëlidhur.

Në zbatim të këtij vendimi:

- Bashkia Himarë do të vijojë procedurat pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësim deri në miratimin e aktit përfundimtar të shpronësimit;
- strukturat teknike dhe të urbanistikës do të përgatisin dhe administrojnë dokumentacionin teknik e ligjor të nevojshëm;
- Bashkia do të kryejë publikimin dhe informimin e subjekteve të prekura dhe publikut, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- fondet për vlerën paraprake të shpronësimit do të përballohen nga buxheti i Bashkisë Himarë.

IV. Argumentimi dhe përfitimet

Miratimi i këtij projekt-vendimi përmbush disa objektiva të rëndësishëm për Bashkinë Himarë:

- krijon bazën administrative dhe ligjore për vijimin e procedurave të shpronësimit për interes publik;
- mundëson realizimin e projektit të ndërtimit dhe rikualifikimit të rrugës në përputhje me dokumentacionin teknik të miratuar;
- përmirëson infrastrukturën rrugore dhe aksesin në zonën e Borshit;
- rrit sigurinë e qarkullimit dhe standardin e shërbimeve publike;
- kontribuon në zhvillimin ekonomik, urban dhe turistik të zonës;
- garanton zhvillimin e procedurave në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe respektimin e të drejtave të pronarëve të pasurive që preken nga projekti.

V. Përfundime dhe propozim

Duke u bazuar në nevojën për realizimin e projektit “Ndërtim & Rikualifikim i Rrugës Paralele me Rrugën e Plazhit, Borsh”, në dokumentacionin teknik të përgatitur dhe në kuadrin ligjor në fuqi, Bashkia Himarë propozon miratimin e vijimit të procedurave për shpronësim për interes publik, sipas projektit dhe hartës bashkëlidhur projekt-vendimit.

Ky miratim krijon bazën administrative për vijimin e procedurave pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësim, për përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe ligjor, për mbulimin e kostove paraprake të shpronësimit dhe për përmbushjen e detyrimeve ligjore të informimit publik, deri në miratimin e aktit përfundimtar të shpronësimit për interes publik.

Këshilli Bashkiak i Himarës është i ftuar të shqyrtojë dhe të miratojë këtë projekt-vendim, me qëllim vijimin e procedurave ligjore për realizimin e projektit “Ndërtim & Rikualifikim i Rrugës Paralele me Rrugën e Plazhit, Borsh”, në funksion të përmirësimit të infrastrukturës rrugore dhe zhvillimit të qëndrueshëm të territorit të Bashkisë Himarë.



DREJTORIA JURIDIKE

DREJTORI

Ardit Muhametaj



SHKALLE: 1:5000



MIRATOHET

Z. VANGJEL TAVO
KRYETARI I BASHKISE

INFORMACION TE NDRYSHME TE PROJEKTIT
EMERTIMI I PUNIMEVE : KERKESE PER NDERTIM TE R
LLOJI I STRUKTURES : -
ZHVILLUESI : -
PRONARI : -
ADRESA : BORSH -- HIMARE

PARAMETRAT	URBANE HIUB 20.454	SPAS PLANIT
SIPERFAQE E TOKES QE ZHVILLOHET	13208 m ²	
LARTESIA E OBJEKTIT	-	-
NUMRI I KATEVE	-	-
VENDET PER PARKIM	-	-
KOEF SHIFRYT. TERRITORI	-	-
INTENSITET NDERTIMI	-	-

PARAMETRAT	URBANE TE PRONES
SIPERFAQE TOTALE E PRONES QE	-
SIPERFAQE NDERTIMI NENTOKE	-
SIPERFAQE MBI TOKE	-
SIPERFAQE TOTALE NDERTIM (nentoke dhe mbitoke)	-
SIPERFAQE PISHINE	-
NUMRI I KATEVE	-
KOEF SHIFRYT. TERRITORI	-
INTENSITET NDERTIMI	-

TREGUESIT E DISTANCAVE (NE METRA)	
NGA KUFINJTE E PRONES	—
NGA STRUKTURAT TE TJERA	—
NGA RRJETI RRUGOR, (AKSIJ)	—

TE DHENAT MBI PROJEKTUESIT			
PROJEKTUES	Nr. LIC.	FIRMA	ARKITEKTURA
	Nr. LIC.		FIRMA